



Perpara ankthit qe pret Kombetaren ne ndeshjet e radhes nje tjetër pikepyetje lidhet dhe me prezencen e De Biasit ne krye te Kombetares Shqiptare. Ditët e fundit vemendja eshte kthyer nga trajneri italian i cili ne nje Konferencë per Shtyp nuk e ka mohuar deshiren qe ka, per te rinovuar me skuadren kuq e zi.

"Po ua them pa me pyetur ju. Kam shprehur me kohe vullnetin per te lidhur me Federaten edhe nje kontrate tjetër dy-vjeçare, por nderkohe kam pasur edhe disa oferta te tjera, duke qene se disa ekipe shohin qe kontrata ime aktuale eshte drejt skadimit", deklaroi De Biasi. Gianni De Biasi i ka kerkur Federates Shqiptare te Futbollit nje rritje prej 30% te kontrates, krahasuar me ate qe ka firmosur dy vite me pare, e cila ne total shkon ne 1 mln e 35 mijë euro , duke mos marre parasysh propozimin e Presidentit Duka i cili propozoi nje rritje prej 10%.